



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:226632
Datë: 05.01.2024
Numri i dokumentit: 05159355

C.nr. 3037/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Besnik Shala, në çështjen juridike civile të procedurës kontestimore të paditësit M.B nga fsh.R, Komuna e P, i përfaqësuar nga F.A, avokat në P, rr.”.....” pn, kundër të paditurës K.S.E, rr.”.....” nr.... P, me bazë juridike Kompensim Dëmi , vlera e kontestit 2,500.00 euro, jashtë seance me datë 05.01.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit M.B nga fsh.R, K.P, kundër të paditurës K.S.E, rr.”.....” nr., P, me bazë juridike Kompensim Dëmi , vlera e kontestit 2,500.00 euro

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.25.10.2023, kundër të paditurës, me bazë juridike Kompensim Dëmi, vlera e kontestit 2,500.00 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 13.12.2023, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, pasi që paditësi e ka realizuar interesin juridik në procedurë jashtëgjyqësore duke lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3037/23 dt.05.01.2024

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.